



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15. 07. 2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Halil Jakimi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për korporatën e investimeve shqiptare” (*Komisioni për dhënie mendimi*)

Marrin Pjesë:

Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Robert Bitri, Kujtim Gjuzi, Zef Shtjefni, Edmond Leka, Fadil Nasufi, Vullnet Sinaj, Ilir Pendavinji dhe Edlira Hyseni.

Mungojnë:

Niko Peleshi, Lefter Koka dhe Nimet Musaj.

Të ftuar:

Belinda Ikonomi – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Ervin Mete - Drejtor Kabineti

Ermal Frashëri – Anëtar i ekipit të hartimit të projektligjit

Saimir Muçmataj - Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Halil Jakimi – Mirëdita!

Të nderuar anëtarë të komisionit, kolegë deputetë, përfaqësues të ministrisë!

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës së mbledhjes së komisionit për sot kemi për diskutim vetëm projektligjin “Për korporatën e investimeve shqiptare”.

Si fillim dua të theksoj se, në bazë të Rregullores së Kuvendit, nuk është respektuar procedura korrekte për njoftimin. Ky projektligj është futur me procedurë jashtëzakonisht të përshpejtuar, njoftimi është bërë në orën 22:00 të mbrëmjes, materialet përkatëse u janë paraqitur deputetëve sot, kurse raporti i ri me ndryshimet përkatëse nga FMN-ja, Banka Botërore dhe Bashkimi Europian është paraqitur vetëm 20 më parë.

Në emër të deputetëve të opozitës dhe të Grupit Parlamentar Demokrat, dua të them se ne e kemi cilësuar këtë projektligj një aferë që tenton të cenojë rëndë buxhetin e shtetit, një projektligj që prek investimet publike dhe cenon rëndë disiplinën fiskale. Gjithashtu, ky projektligj do t’i jepte mundësi qeverisë të udhëzonte edhe vendime individuale.

Duke arsyetuar gjithë sa thashë më sipër, me propozim edhe të deputetëve, mendoj që duhet më shumë kohë në dispozicion që ky projektligj të shqyrtohet. Duke parë edhe raportin me ndryshimet përkatëse të FMN-së, Bankës Botërore dhe Bashkimit Europian, të cilat na janë vënë në dispozicion vetëm 20 minuta përpara fillimit të mbledhjes, kërkoj që mbledhja të shtyhet në një ditë tjetër.

Ligji ka problematika, pasi përfiton para publike jashtë buxhetit dhe nuk është subjekt i tatimit. Ky projektligj duhet të jetë objekt i ligjit “Për prokurimin publik”. Pavarësia e Korporatës së Investimeve Shqiptare në vendimet operative në përzgjedhjen e projekteve individuale të investimeve, po ashtu. Me pak fjalë, e vendos qeveria se cilin biznes do të bëjë me para dhe cilin jo, e vendos qeveria përzgjedhjen e klientëve në menaxhimin e parave publike.

Nuk kam çfarë të them më shumë, kështu që e deklaroj mbledhjen të mbyllur

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

Ilir Beqaj – Unë jam dakord me ato që ju thatë për aspektin e procedurës, që një dokument me reflektime të sugjerimeve dhe vërejtjeve të FMN-së dhe të Komisionit Europian na është vënë në dispozicion 20 minuta më parë, ama që kjo çështje ka qenë në kalendar që në muajin mars, këtë e dimë të gjithë, sepse kemi votuar atëherë. Që në muajin

mar kjo është dokument në faqen e parlamentit dhe në kopjet tona këtu. Kështu që, nuk mund të themi që jemi të panjohur me këtë projektligj. Kështu funksionon.

Po t'u kthehem datave, nëpunësit e shërbimeve të Kuvendit i dinë, ka një datë kur ka hyrë në kalendar dhe që nga ai moment është në faqen e Kuvendit. Ka tre muaj që është në faqen e Kuvendit. Fakti që edhe në opinionin publik ka pasur diskutime, tregon që kjo nuk është një gjë e papritur dhe e sjellë në mënyrë diversante për diskutim. E vetmja gjë është kjo, sepse kjo lidhet me momentin praktik të fillimit të diskutimeve në komision.

E dyta, përderisa ju vetë, në parashtrësë, bëtë disa vlerësime të përgjithshme, minimalisht do të thotë se keni pasur kohë ta shqyrtoni dhe dhatë opinionin tuaj.

Për sa i përket kërkesës për të shtyrë mbledhjen, propozimi është i mirëpritur, por, zakonisht, në komisione këto vendime merren me votë.

Faleminderit!

Halil Jakimi – Absolutisht, është e vërtetë ajo që ju thatë që është në faqen zyrtare të parlamentit, por njoftimi nuk mund të bëhet në mbrëmje vonë dhe propozimi me ndryshimet përkatëse të bëhet vetëm 20 minuta përpara fillimit të mbledhjes. Ju e dini që rekomandimet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për ndryshimet në këtë projektligj janë shumë të rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çështje diskutimi, por unë mendoj se deputetët kërkojnë kohën e nevojshme dhe nuk mund ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, unë nuk doja që mbledhjen e parë që drejtoj ta zhvilloja në këtë mënyrë.

Nuk dua ta zgjas më shumë, por e deklaroj mbledhjen të mbyllur këtu dhe nuk dua të vazhdojmë me diskutime dhe parashtrime.

MBYLLET MBLEDHJA